

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6835
E hënë, 27 shkurt 2023
çmimi 0.40

Kurti viziton
familjen Demaci dhe
familjen Dehari. Faqe 3



MACRONI, SCHOLZI DHE MELONI I SHKRUAJNË KURTIT, IA PËRMENDIN THEMELIMIN E ASOCIACIONIT



Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti dhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiç, më 27 shkurt do ta zhvillojnë takimin e nivitet të lartë në Bruksel, nën ndërmjetësimin e të dërguarit evropian për dialogun,

Miroslav Lajçak. Një ditë para këtij takimi, Kurti ka pranuar një letër të përbashkët nga presidenti i Francës, Emmanuel Macron, kancelari i Gjermanisë, Olaf Scholz dhe kryeministrja e Italisë, Giorgia

Meloni, në lidhje me takimin që do të mbahet në Bruksel dhe propozimin evropian. Liderët evropianë kanë bërë thirrje të respektohen të gjitha marrëveshjet e arritura në kuadër të dialogut

**RASHITI:
DO TË KETË
PRESION TË MADH
NDËRKOMBËTAR QË,
KRAHAS NËNSHKRIMIT
TË MARRËVESHJES,
TË KETË ZBATIM TË
SHPEJTË TË
ASOCIACIONIT.** Faqe 4-5



ANALIZË E SHKURTËR E
DOKUMENTIT TË ASHAK-UT
**PËRMBYSJA E REALITETIT
SHQIPTAR, NGA KEQDASHJA
APO NGA PADITURIA?**

Milazim
KRASNIQI
Faqe 6-7



RENOVA
PUTZ
Makedoni Xheqisht-Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755 Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501289 E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122 Internet Website, Marketing...

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

[facebook.com
Gazeta "Epoka e re"](https://facebook.com/Gazeta%22Epoka%20e%20re%22)



AKTUALE



**KËRKOHET ASOCIACION I
KOMUNAVE SHQIPTARE NË
MAQEDONINË E VERIUT** F. 2

**MUNGESA E BORËS NË EVROPË,
PARALAJMËRIM PËR THATËSIRE
EKSTREME** F. 2

**MBI 22 MIJË FAMILJE NË KOSOVË
PËRFITUJSE TË SKEMËS SOCIALE**

F. 8

EKONOMI



**KËTË VIT PRITET STABILIZIMI I
ÇMIMEVE DHE ULJA E INFLACIONIT**

F. 8

**VLERA E VALUTËS IRANIANE BIE NË
NIVELE REKORDE** F. 8

SPORT



**PRISHTINA SHIJON FITOREN E PARË
NË PRANVERË, DUKAGJINI NDALI
BALLKANIN** F. 8

Shefja e BE-së bën thirrje për reformë të azilit pas vdekjeve të migrantëve në Itali

BRUKSEL, 26 SHKURT - Shefja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, ka bërë thirrje për përparim në reformën e bllokuar të Bashkimit Evropian për azil, pas raportimeve për vdekjen e mbi 50 migrantëve në Itali. Von der Leyen ka thënë se vdekjet e raportuara në orët e hershme të së dielës janë tragjedi që e kanë lënë atë "thellësish të pikëlluar". Varka e mbingarkuar, me më shumë se 120 migrantë, është

përmbytur në rajonin e Kalabrisë, në jug të Italisë. Rreth 80 persona kanë shpëtuar. "Ne duhet t'i dyfishojnë përpjekjet tona për Paktin e Migrimit dhe Azilit dhe planin e veprimit për qendrën e Mesdheut", ka thënë ajo. Një numër i madh i migrantëve - që i ikin konfliktit dhe varfërisë - e marrin rrugën nga Afrika për në Itali çdo vit. Ende është e paqartë kombësia e

viktimate, mirëpo agjencitë lokale kanë raportuar se migrantët janë nisur nga Irani, Iraku, Siria, Afganistani, Pakistani dhe Somalia. Edhe kryeministrja italiane Giorgia Meloni ka shprehur "pikëllim të thellë" për përmbytjen e varkës dhe është zotuar se do t'i japë fund migrimit të parregullt detar si mënyrë për të parandaluar më shumë tragjedi.



Kërkohet asociacion i komunave shqiptare në Maqedoninë e Veriut

SHKUP, 26 SHKURT - Partia Alternativa në Maqedoninë e Veriut po kërkon asociacion të komunave shqiptare ashtu siç kërkojnë serbët në Kosovë. "Në kohën kur Kosova gjendet para marrëveshjes finale për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë, dhe kur secili diplomat perëndimor që shkon në Prishtinë e përsërit refrenin 'të bëhet Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë', pyetja që duhet të shtrohet është se pse partitë shqiptare në Maqedoninë e Veriut, ato që kanë komuna (Bashkimi Demokratik për Integrim, Aleanca për Shqiptarët dhe BESA), nuk e ngjenë një iniciativë për themelimin e Asociacionit të Komunave Shqiptare në Maqedoninë e Veriut po me ato kompetenca që bashkësia ndërkombëtare kërkon t'i ketë Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë", ka deklaruar Zeqirja Ibrahimë nga partia "Alternativa". Kjo parti ishte pjesë e qeverisë me tri ministri, por kaloi në opozitë për shkak të mosmarrëveshjeve lidhur me ndarjen e posteve, pas vendimit që pushtetit t'i



bashkohet edhe partia Aleanca për Shqiptarët. Kërkesa e saj për Asociacionin e Komunave Shqiptare është refuzuar nga partitë e tjera, përvëç Lëvizjes Besa, e cila ka thënë se do ta shqyrtojë një propozim të tillë. Bashkimi Demokratik për Integrim, që drejtobet nga Ali Ahmeti, tha se një propozim i tillë është "anti-perëndimor" dhe i dëmshëm për proceset nëpër të cilat po kalon Kosova. "Një

propozim i tillë është patetik, antiamerikan dhe antievropian, është i dëmshëm për zgjidhjen përfundimtare të çështjes së Kosovës. Përpjekje e pasuksesshme për të mbijetuar në skenën politike pas fiaskos dhe rreshtimit krejtësisht të gabuar dhe destruktiv", thuhet në reagimin e BDI-së. Lidhja Social-Demokrate thotë se komunat në Maqedoninë e Veriut kanë të drejtë bashkëpunimi andaj nuk kanë

nevojë për asociacione, apo forma të tjera të bashkimit. "Situata në Kosovë nuk mund të pasqyrohet në vendin tonë në asnjë mënyrë. Sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe Ligjit për Bashkëpunim Ndërkomunal, bashkëpunimi ndërmjet komunave në Maqedoninë e Veriut është absolutisht i mundshëm. Çdo komunë mund të bashkëpunojë në çfarëdo forme, kur gjen interesim për një temë të caktuar. Ne e

konsiderojmë këtë kërkesë si joserioze, që të mos përdoret për të fituar pikë politike dhe është e papranueshme", ka deklaruar Sanela Shkrijel nga Lidhja Social-Demokrate e kryeministrat, Dimitar Kovaçevski.

Kryetari i VMRO DPMNE-së, Hristijan Mickovski, tha se një ide e tillë "mund t'i përkëqësojë marrëdhëni ndëretnike" dhe se raportet dhe të drejtat e bashkësive etnike, në veçanti të asaj shqiptare janë të rregulluara me Marrëveshjen e Ohrit.

Disa parti më të vogla maqedonase propozimin e Alternativës e kanë quajtur "ide nacionaliste që dëmton perspektivën evropiane të Maqedonisë së Veriut".

Kosova dhe Serbia kanë arritur marrëveshje për Asociacionin më 2013 dhe më pas më 2015 mbi parimet për themelimin e tij. Po më 2015, Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka gjetur se marrëveshja nuk është në harmoni të plotë me Kushtetutën.

Serbia kërkon që Kosova t'i zbatojë marrëveshjet e aritura, por Qeveria e Kosovës është deklaruar kundër një asociacioni njëetnik.

Mungesa e borës në Evropë, paralajmërim për thatësirë ekstreme

ROMË, 26 SHKURT - Shqetësimet për thatësirë sa shkojnë e rriten në Evropë, pasi matjet e fundit në Alpe kanë treguar vetëm sasi të vogla të akumulimit këtë vit, derisa reshjet e shiuat në vendet si Italia dhe Franca kanë qenë shumë të ulëta.

Në Francë, Zvicër, Itali dhe disa pjesë të Austrisë ka shumë më pak borë sesa mesatarja, ka thënë meteorologu Klaus Haslinger nga shërbimi shtetëror i motit në Austri.

Në Itali, organizata joqeveritare Legambiente është duke

paralajmëruar që 53 për qind më pak borë ka rënë në Alpet italiane në muajt e fundit. Problemi nuk qëndron vetëm te mungesa e borës, por edhe te mungesa e shiuat. Në Francë, pas disa javëve pa shi, ka shqetësimë për një verë të dytë me thatësira dhe kufizime në ujë. Haslinger ka thënë se të dhënët tregojnë se ngrohja globale është duke favorizuar këto temperaturat, duke krijuar më shumë kushte për thatësira në të ardhmen. "Nëse moti në pranverë do të jetë i ngjashëm me atë të vitit 2022,

thatësira do të jetë shumë më e keqe", ka paralajmëruar Josef Eitzinger, meteorolog në Universitetin për Burime Natyrore në Vjenë. Së fundi është raportuar se kanalet më të famshme në Venecia janë tharë dhe se i gjithë veriu i Italisë është duke u përballur me probleme të lidhura me motin. Sipas gazetës italiane "La Repubblica", pas një muaji pa reshje në rajonin Emilia-Romagna, ekziston rreziku i rënies prej 40-përqindësh të prodhimit kombëtar të ushqimit.



Macroni, Scholzi dhe Meloni i shkruajnë Kurtit, ia përmendin themelimin e Asociacionit



Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti dhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiç, më 27 shkurt do ta zhvillojnë takimin e nivelit të lartë në Bruksel nën ndërmjetësimin e të dërguarit evropian për dialogun, Miroslav Lajčák. Një ditë para këtij takimi, Kurti ka pranuar një letër të përbashkët nga presidenti i Francës, Emmanuel Macron, kancelari i Gjermanisë, Olaf Scholz dhe kryeministrja e Italisë, Giorgia Meloni, në lidhje me takimin që do të mbahet në Bruksel dhe propozimin evropian. Liderët evropianë kanë bërë thirrje që të respektohen të gjitha marrëveshjet e arritura në kuadër të dialogut.

EPOKA ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 26 SHKURT - Presidenti francez Emmanuel Macron, kancelari gjerman Olaf Scholz dhe kryeministrja italiane Giorgia Meloni e kanë mirëpritur vendimin e kryeministrat të Kosovës, Albin Kurti, për ta pranuar propozimin e Bashkimit Evropian për normalizim të marrëdhënieve dhe e kanë përmendur nevojën e madhe për krijimin e kushteve drejt finalizimit dhe zbatimit të saj. Të tre liderët i kanë bërë këto

deklarata në një letër nisur kryeministrit Kurti një ditë para takimit të tij me presidentin serb Aleksandër Vuçiç në Bruksel, nën ndërmjetësim të Bashkimit Evropian. "Në konkluzionet e 9 shkurtit, Këshilli Evropian e ka shprehur mbështetjen e tij për këtë marrëveshje të rendësishme dhe të njëjtën kohë u ka bërë thirrje Serbisë dhe Kosovës t'i zbatojnë, plotësisht dhe pa kushte, obligimet që kanë marrë në kuadër të dialogut, përfshirë marrëveshjet e vitit 2013 dhe 2015 për të krijuar Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe",

kanë thënë liderët evropianë. Ata kanë thënë se presin që në takimin e 27 shkurtit të diskutohet për propozimin e BE-së dhe obligimet që dalin nga procesi i dialogut, të ndërmjetësuar nga blloku evropian. Duke e përmendur rëndësinë e zbatimit të marrëveshjeve dhe arritjes së pajtueshmërisë, Macron, Scholz dhe Meloni kanë thënë se janë të bindur që nga një përparim i tillë përfitojnë qytetarët si dhe avancohet rruga e Kosovës drejt integrimeve evropiane.

Kosova dhe Serbia kanë arritur marrëveshje për Asociacionin më 2013 dhe më pas më 2015 mbi parimet për themelimin e tij. Po më 2015 Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka gjetur se marrëveshja nuk është në harmoni të plotë me Kushtetutën. Serbia kërkon që Kosova t'i zbatojë marrëveshjet e arritura, por Qeveria e Kosovës është deklaruar kundër një asociacioni njëetnik. I dërguari i BE-së për dialogun, Miroslav Lajčák, ka deklaruar se në takimin e 27 shkurtit në

Bruksel pret që palët të pajtohen për afatet e zbatimit të propozimit evropian.

Injohur në publik si plani franko-gjerman, propozimi i BE-së për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë është thënë se shërben si rrugë drejt marrëveshjes finale mes dy vendeve.

Planin e kanë pranuar si Kosova ashtu edhe Serbia, por ai nuk është prezantuar asnjëherë në publik. Aty nuk përmendet në mënyrë specifike njohja, por parashihen të drejtë të barabarta për Kosovën dhe Serbinë, respektim i integritetit territorial, paprekshmëri e kufijve, njohje e simboleve shtetërore dhe një aranzhim i veçantë për komunitetin serb në Kosovë.

Edhe këshilltari i lartë i Departamentit amerikan të Shtetit, Derek Chollet, ka deklaruar më 25 shkurt se i ka thënë kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, që tani është koha për të diskutuar rreth Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Po ashtu, Chollet i ka thënë të dieën presidentin serb Aleksandër Vuçiç se Shtetet e Bashkuara e mbështetin plotësisht propozimin e Bashkimit Evropian për normalizim të marrëdhënieve në mes të Prishtinës dhe Beogradit.

Përmes një bisede telefonike, Chollet i ka thënë Vuçiçit se pret që takimi i 27 shkurtit me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, në Bruksel, të jetë konstruktiv dhe me përparim të dukshëm drejt marrëveshjes. Kosova dhe Serbia i kanë nisur negociatat e ndërmjetësuara nga Bashkimi Evropian më 2011. Përgjatë kësaj kohe janë nënshkruar diku 33 marrëveshje, por jo të gjitha janë zbatuar. Tani të dyja vendet kanë synime të ndryshme për marrëveshjen finale. Kosova insiston në njohje reciproke, Serbia kërkon zgjidhje kompromisi.

Kurti viziton familjen Demaci dhe familjen Dehari

PRISHTINË, 26 SHKURT - Kryeministri Albin Kurti i shoqëruar nga Xhelal Sveçla, Albulena Haxhiu, Arbërie Nagavci dhe zyrtarë të LV-së, ka vizituuar të dielën familjen Demaci dhe familjen Dehari. Ai ka treguar se kjo vizitë kishte një qëllim. "Adem Demaci e Astrit Dehari sot e kanë ditëlindjen. Vizituam familjet e tyre - përplot kujtime mallengjyes e udhërrëfye. Njësi si e vërteta e shqiptarëve në raport me Serbinë, tjetri si konfirmim i asaj të vërtete dhe drejtësi ende e munguar në Kosovë. Kush jehon, rron edhe kur s'jeton. Si këta dy", ka shkruar Kurti në "Facebook".





Rashiti: Do të ketë presion të madh ndërkombëtar që, krahas nënshkrimit të marrëveshjes, të ketë zbatim të shpejtë të asociacionit

Naim Rashiti, drejtor i Grupit Ballkanik për Politika në Prishtinë, ka thënë se asociacioni ose zbatimi i marrëveshjeve të kaluara, nuk do të hiqet kurrë nga dokumentet dhe kërkesat e faktorëve ndërkombëtarë për Kosovën. Në një intervistë dhënë për "Radion Evropa e Lirë", ai ka theksuar se do të ketë presion të madh ndërkombëtar që, krahas nënshkrimit të marrëveshjes, të ketë zbatim të shpejtë të asociacionit. Ai thotë se në takimin e paralajmëruar më 27 shkurt në Bruksel, ndërmjet kryeministrat të Kosovës, Albin Kurti, dhe presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiç, pritet t'i jepet formë procesit që do të çojë te marrëveshja mbi bazën e propozimit të Bashkimit Evropian

PRISHTINË, 26 SHKURT - Në takimin e paralajmëruar për 27 shkurt në Bruksel ndërmjet kryeministrat të Kosovës, Albin Kurti, dhe presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiç, pritet t'i jepet formë procesit që do të çojë te marrëveshja mbi bazën e propozimit të Bashkimit Evropian. Kështu thotë në intervistën për "Radion Evropa e Lirë", Naim Rashiti, drejtor i

Grupit Ballkanik për Politika në Prishtinë. Ai e shih si problem, siç e quan, hezitim e faktorit ndërkombëtar dhe mosbesimin se palët po shkojnë drejt marrëveshjes, që ai thotë se është afër, por "u mbetet ndërkombëtarëve t'i sinkronizojë veprimet me palët". "Për mua ky mbetet shqetësimi më i madh, sepse faktori ndërkombëtar ende po e mban

distancën [duke thënë] ja plani, pranojeni, vazhdoni, konsultohuni, finalizojeni", thotë Rashiti.

Ai e shih si mjaft të rëndësishme përbajtjen e propozimit evropian që, sipas tij, "e definon qartë karakterin e një marrëveshjeje ndërkombëtare në përputhje me të drejtënjëndërkombëtare dhe kartën e OKB-së". Rashiti thotë se BE-ja nuk duhet ta cilësojë marrëveshjen eventuale si "të ndërmjetme", por thjesht si marrëveshje për normalizimin e marrëdhënive Kosovë - Serbi. Ai nuk beson që kryeministri Kurti do ta nisë formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe pa nënshkrimin marrëveshjes mbi bazën e propozimit të BE-së.

Z. Rashiti, më 27 shkurt pritet të takohen në Bruksel kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, dhe

presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiç. Çfarë mund të pritet nga ky takim?

Naim Rashiti: Besoj se përpjekjet e Bashkimit Evropian dhe faktorit ndërkombëtar janë që me këtë takim në njëfarë forme të formalizohet dialogu rrëth planit final të propozuar, franko-gjerman apo evropian. Ky takim besoj se do t'i japë formë procesit deri te marrëveshja. Do të jetë shumë keq nëse dështon, nëse acarohen marrëdhëni, nëse nuk ec ashtu siç është paraparë. Por, do të jetë një hyrje në procesin intensiv për një marrëveshje finale. Palët nuk do të kenë më shumë "po" për këtë marrëveshje, nuk do të kenë më shumë miratim, më shumë përkrahje për këtë plan sesa kaq sa kanë dhënë. Tash i mbetet faktorit ndërkombëtar t'i bëjë hapat e duhur, sekuençimin e duhur, veprimet e duhura, që në formën klasike të

ndërmjetësimit dhe jo vetëm të lehtësimit, t'u mundësojë palëve të arrjnë një pajtim final për një marrëveshje e cila do të nënshkruhet. Për mua ky mbetet shqetësimi më i madh, sepse faktori ndërkombëtar ende po e mban distancën [duke thënë] ja plani, pranojeni, vazhdoni, konsultohuni, finalizojeni. Këtu duhen negociata klasike, sekuençim të veprimeve, konsulta intensive, diskutime të planit, aneksit, elementeve që janë diskutabile, në mënyrë që të bëjmë një pako për nënshkrim final, e cila do të përfshinte, edhe siç është paraparë, pjesën e zbatimit. E gjithë kjo kërkon shumë dinamikë intensive të faktorit ndërkombëtar, konsulta me palët, ndoshta diku edhe negociata disaditore, përgatitje, gjë që do të conte në një marrëveshje finale. Është një momentum i mirë dhe uroj që të mos humbet.

A ka sinjale ose indikacione se ndonjëra nga palët mund t'i thotë "jo" këtij propozimi?

Naim Rashiti: Kjo edhe mund të ndodhë. Ky edhe është problemi më i madh gjatë këtij procesi, sepse faktori ndërkombëtar, me gjasë, nuk është tërësisht krejtësisht i bindur që të dy palët, Kosova dhe Serbia, do të shkojnë drejt marrëveshjes. Besoj se po të kishin qenë të bindura, do të kishte pasur hapa më të shpejtë. Por, në anën tjetër, nuk do të ketë "po" më të madhe nga Prishtina dhe Beograd i sëska qaq. I mbetet faktorit ndërkombëtar që t'i sinkronizojë veprimet me palët. Kështu që, secila prej të tri palëve po e presin njëra-tjetrën. Faktori ndërkombëtar po pret më shumë mbështetje të palëve për marrëveshjen dhe procesin, më shumë angazhim. Ndërsa, palët po presin më shumë angazhim të faktorit ndërkombëtar. Ndoshta këto pritje, në takimet e javëve të ardhshme, fillojnë të zbuten, në mënyrë që të ketë një kohezion më të madh të veprimeve të të gjitha palëve. Por, prapë mendoj se përgjegjësia kryesore për ta sinkronizuar tërë këtë proces, mbetet te faktori ndërkombëtar, sidomos në rastin e Kosovës. Kosova ka nevojë për disa veprime të tjera, me miqtë e saj, me BE-në, me vendet anëtare të BE-së, me ShBA-në, që ta

formësojë më shumë përbajtjen, kuptimin e marrëveshjes. Jo vetëm të marrëveshjes së dokumentit fillestar, por të gjithë fazës së zbatimit. Kjo do të jetë kyçe se si marrëvesha do të interpretohet ndërkombëtarisht. Jo vetëm në aspektin e zbatimit dhe ndikimit në terren, por do ta definojë jehonën, ndikimin ndërkombëtar që aq shumë i duhet Kosovës, sidomos në raport me vendet që nuk e kanë njohur, me natyrën dhe karakterin e marrëveshjes ndërkombëtare, me konkluzat e BE-së dhe kështu me radhë.

Palët e kanë pranuar propozimin e Bashkimit Evropian përmarrësimin e marrëdhënive Kosovë - Serbi. Çka i ofron ky propozim Kosovës dhe çka i ofron Serbisë?

Naim Rashiti: Ky propozim është shumë konkret. I ofron Kosovës një marrëveshje ndërkombëtare me Serbinë, lehtesar nga BE-ja dhe mbështetur nga faktori ndërkombëtar e cila e definon qartë ndarjen e sovranitetit ndërmjet njësës dhe tjetrës. Kjo është më e rendësishmja. Pra, e definon qartë karakterin e një marrëveshjeje ndërkombëtare, në përputhje me të drejtëndësishmja. Kjo është shumë e rendësishme. Në të njëjtën kohë,

definon qartë raportet ndërmjet dy vendeve dhe obligimet e njësës dhe tjetrës. Në këtë rast flasim më shumë përmisë obligime të Kosovës në rapport me zbatimin e marrëveshjeve të kaluara dhe në njëfarë forme, rregullimin e statusit të komunitetit serb brenda Kosovës, siç flitet atje përmisë menaxhim vetjak, përmisë linjë komunikimi me qeverinë përmisë zbatimin e marrëveshjes dhe kështu me radhë. Përmendimin tim, nëse zbatohet [marrëvesha] dhe krijon këtë mbështetje ndërkombëtare, ky është një hap marramendës, një hap shumë i madh përmisë Kosovës drejt konsolidimit ndërkombëtar të sovranitetit të saj, në raport me zhvillimet globale të sigurisë që po ndodhin. Kjo është më e rendësishmja. Përmisë Serbinë [marrëvesha] ofron normalizimin të marrëdhënive me Kosovën, i devijon njohjes formale, të cilën e ka theksuar gjithmonë dhe shihet që nuk ka gatishmëri përtak bërë, si dhe i hap rrugë integrimit të saj përmisë BE. Unë jam i bindur që Kosova, Serbia dhe rajoni do të duken tërësisht ndryshe në rast se kjo marrëveshje nënshkruhet, por edhe zbatohet. BE-ja nuk do ta kualifikojë si marrëveshje të përfunduar, pa zbatimin e saj. Besoj se kjo është e mira e këtij propozimi.

Cilat pika të këtij propozimi prisni se mund të janë problematike përmisë zbatuar?

Naim Rashiti: Definicioni i marrëdhënieve ndërshtetëre është i rregulluar shumë mirë. Brenda kësaj periudhe përmisë zbatim, Kosovës i njihen: sovraniteti, simbolet shtetërore, identiteti shtetëror ndërkombëtar. Ka pika të cilat do të mbeten tema. Ka shumë çështje që kjo marrëveshje nuk i përfshinë si, përmisë shembull, të pagjeturit, çështjet e së kaluarës, të luftës, pajtimit, suksesionit dhe të tjera. Por, në këtë aspekt, aty ku do të ketë sfida, janë pika 11 dhe pika shtatë, ku do të ketë diskutime se si do të duket zbatimi i marrëveshjeve të kaluara, si do të duket vërqeverisja përmisë komunitetit serb. Jam i bindur se do të ketë diskutime të gjata, të vështira. Por, nëse i gjithë ky proces çon drejt asaj që është më e rendësishmja, që prioriteti vihet te marrëdhënia bilaterale mes dy shteteve të pavarura, besoj se gjithçka është e bërë. Kjo është ajo që i ka munguar marrëveshjes së vitit 2013 [në dialogun Kosovë - Serbi në Bruksel]. Ajo ka folur kryesisht përmisë çështjen e komunitetit serb, përmisë veriun, përmisë integrimin e serbëve brenda institucioneve, përmisë përfaqësimin jashtë, por nuk ka folur aspak përmisë çështjeve ndërmjet dy shteteve, gjë që është problema kryesore. Në qoftë se kemi një pajtim të fuqishëm, zbatim të shpejtë të aspekteve që rregullojnë marrëdhëniat e brendshme dhe fillojnë ta respektojnë juridikacionin, sovranitetin e njëri-tjetrit, këtu mund të flasim edhe përmisë elemente të njohjeve reciproke. Por, nëse kemi këtu telashe, atëherë do të kemi telashe edhe në të gjitha aspektet e tjera të draft-marrëveshjes. Çështja tjetër, që mbetet diskutabile, është natyra e këtij dokumenti që po quhet "i ndërmjetmë". Kjo e bën pak më të vështirë. Unë mendoj se po quhet si "i ndërmjetmë" përmisë faktin se faktori ndërkombëtar do ta shohë si marrëveshje vetëm pas zbatimit. Besoj se pas zbatimit BE-ja duhet ta vendosë në konkluzat e saj si marrëveshje që ka bërë normalizimin e marrëdhënive ndërmjet dy vendeve. Nëse BE-ja arrin ta bëjë këtë, atëherë do të kemi efekt shumë të madh të saj në çështjet përmisë cilat Kosova ka nevojë më së shumti, siç janë: njohja nga pesëshja (pesë vendet e BE-së që nuk e kanë njohur Kosovën), marrjen e statutit të kandidatit (përmisë anëtarësim në BE), anëtarësimi në Këshill të Evropës. Do të shohim veprime të

njëpasnjëshme të cilat do ta vendosin Kosovën në një stadhë tërësisht tjetër.

Propozimi parasëzohet zbatimin e të gjitha marrëveshjeve të arritura në Bruksel. Në mesin e tyre është edhe ajo e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, gjë që kërkohet edhe nga bashkësia ndërkombëtare, përfshirë edhe aleatët e Kosovës. A prisni që Kosova do t'u përgjigjet pozitivisht këtyre thirrjeve para një marrëveshjeje finale?

Naim Rashiti: Asociacioni ose zbatimi i marrëveshjeve të kaluara nuk do të hiqet kurrë nga dokumentet dhe kërkuesat e faktorëve ndërkombëtarë përmisë Kosovës. E bukura e këtij procesi është se Asociacioni është vendosur në një kornizë më të madhe të normalizimit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Përfitimi më i madh i Kosovës është që ta bëjë Asociacionin në kuadër të kësaj marrëveshjeje. Në gjykimin tim, duket qartë se Qeveria [e Kosovës] nuk do të bëjë ndonjë lëvizje para marrëveshjes. Por, qeveria ka dhënë indikacione se do ta bëjë Asociacionin, do t'i zbatojë marrëveshjet pas nënshkrimit të marrëveshjes së ndërmjetme. Megjithatë, kjo nuk po e kënaq faktorin ndërkombëtar. Kjo shihet dhe ka kërkesa intensive. Megjithatë, unë besoj se është mungesë e sekuencimit të veprimeve nga ana e faktorit ndërkombëtar, sepse do të mund të uleshin palët që ta dizajnojnë, ta rregullojnë dhe ta hartojnë statutin e Asociacionit apo parimet, në përputhje me vendimin e Gjykatës Kushtetuese [të Kosovës] dhe t'ia bashkëngjitin kësaj marrëveshjeje. Prandaj, kur po them që palët nuk kanë një "po" më të madhe sesa kaq, sekuencimi i veprimit të faktorëve ndërkombëtarë do ta bënin më të lehtë që këtë "po" ta bënin një "po" të vërtetë dhe me nënshkrim. Jam i bindur që pas nënshkrimit të marrëveshjes, të gjitha marrëveshjet do të zbatohen. Mos të harrojmë që disa nga marrëveshjet e kaluara zbatohen vetveti, siç janë: njohja e simboleve, targat. Shumë aspekte të marrëveshjeve nga dialogu politik zbatohen, ndërsa disa aspekte teknike mbeten përmisë zbatuar domosdo, sikurse: integrimi i policisë, gjykatësve, mbrojtjes civile, fondi doganor, Asociacioni. Kështu që, nuk po shoh që mund të ndodhë diçka përpara nënshkrimit të marrëveshjes. Por, do të ketë presion të madh ndërkombëtar, që krahas nënshkrimit të marrëveshjes, të ketë zbatim të shpejtë të Asociacionit.



ANALİZË E SHKURTËR E DOKUMENTIT TË ASHAK-ut

Përbysja e realitetit shqiptar, nga keqdashja apo nga padituria?



Milazim KRASNIQI

Dilema e parë është se a ia vlen të diskutohet për një dokument të shpallur inekzistent? Dokumenti i ASHAK-ut pas publikimit, pas disa retushimeve dhe shumë reagimeve, u tërroq tërësisht. Fakti që një dokument dhe autori nuk e përballon kritikën, zbulon dobësinë themelore, pra, nuk është produkt i një studimi, po është produkt i një spekulimi. Megjithatë, edhe pse i shpallur si inekzistent, virulanca e atij dokumenti mbetet e rrezikshme, siç është e rrezikshme virulanca e mikrobeve anaerobe. Dokumenti është fshehur, por akterët dhe sidomos mendësia që e ka prodhuar, janë prezent dhe aktiv edhe më tutje, jo vetëm në Akademinë e Arteve dhe Shkencave të Kosovës po edhe në një numër të konsiderueshëm të institucioneve politike e kulturore. Këta akterë dhe këto mendësi janë trashëgimi e periudhës së errët të okupimit dhe të komunizmit, e cila ka prodhuar një shkallë të lartë çmíralizimi, veçmas te elitat politike, intelektuale e fetare. Rrjedhimisht, ky dokument është produkt i asaj mendësie, të infektuar nga mazohizmi,

hipokrizia, kompleksi i inferioritetit dhe antishqiptarizmi. Mund të jetë rastësi, por pak a shumë ngjashëm si me këtë dokumentin e ASHAK-ut, ka ndodhë me Memorandumin e ASSHA të vitit 1986: ai dokument u publikua vetëm pjesërisht, u shpall se nuk ishte dokument i Akademisë, u përmendën disa nga autorët, pastaj u tërroq nga qarkullimi, u shpall inekzistent. Në rastin e Memorandumit të ASSHA-s, zbatimi i direktivave vazhdoi me vendosmëri nga regjimi serb. Shpresoj senë këtë pikë dokumenti i ASHAK ka fat tjetër. Beso se askush nuk do të mund ta zbatojë në realitet, edhe pse afërsia konceptuale e qeverisë aktuale me të është evidente në disa pika, veçmas sa u përket qëndrimeve mazohiste për raportet ndëershqiptare dhe zhvillimeve në raport me Gjykatën Speciale. Por, në rastin tonë, nuk ka as fuqi e as guxim për të bërë ndonjë veprim konkret. Analiza themelore e këtij dokumenti në këtë rast do të jetë më shumë filologjike, pra, analizë e tekstit dhe shfrytëzimeve semantike që ka prodhuar. Natyrisht kjo qasje do të

ndërlidhet edhe me një perspektivë historiografike dhe kulturore, pasi që edhe janë fusha të ndërthurura në këtë dokument. Në fillim të dokumentit thuhet: "Ky dokument është një analizë e përgjithshme e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës". Pra, që në fjalinë e parë bëhet e ditur se dokumenti është i Akademisë. Deklaratat dhe reagimet e mëvonshme, nuk e zhbëjnë kuptimin eksplisit të këtij teksti. Teksti i publikuar gjithnjë mbetet origjinal dhe botimet e tjera janë versione, variante, retushime, ribotime. Origjinali nuk cenohet as nga rishikimet e as nga censurimet e mëvonshme. Po të zhbëj origjinali, ne nuk do të kishim një kulturë të mbështetur në tekst, sidomos nga zbulimi i Guttenbergut e këndeji. Prandaj, dokumenti original me titull "SYNIMET DESTABILIZUESE TË SERBISE NË KOSOVË DHE NË BALLKANIN PERËNDIMOR" nga pikëpamja filologjike është dhe mbetet përgjithmonë tekst i Akademisë.

Jo vetëm nga pikëpamja filologjike po edhe nga ajo thjesht administrative dokumenti mbetet i ASHAK, duke marrë para sysht statusin ligor që ka Akademia dhe mënyrën e funksionimit të saj. Askush nuk mund të pretendojë se mund të hartojë një dokument krye më vete, në një institucion publik të atij niveli. Për këtë arsy, problem mbetet të vihen në dispozicion të publikut procesverbalet dhe vendimi për hartimin e dokumentit, duke përfshirë edhe honorarët e akorduar për punën e investuar. Në paragrafin e dytë thuhet po aq qartë: "Qëllimi i hartimit të këtij dokumenti është krijimi i një pasqyre të përgjithshme të rrëthanave të krijuara në marrëdhëni e Kosovës me Serbinë." Por, në strukturën e dokumentit ka digresione e shkarje të mëdha nga ky qëllim i proklamuar. Ngjashëm me disa romane që strukturohen me disa linja fabulative, edhe ky dokument ka disa linja tematike që nuk janë të harmonizuara.

Po të ndiqej qëllimi i proklamuar "krijimi i një pasqyre të përgjithshme të rrëthanave të krijuara në marrëdhëni e Kosovës me Serbinë" do të bëhej analiza e atyre marrëdhënieve që janë krijuar pas pavarësimit të Kosovës, kur Kosova është bërë subjekt rivalizimi me Serbinë, gjë që ka prodhuar konsekuencia të reja në raportet e ndërsjella, si edhe në realitetin gjeopolitik. Jo e kaluara. Dhe aq më pak raportet brendashqiptare, sepse ato nuk kondicionohen nga raportet e Kosovës me Serbinë. Natyrisht as aspektet e qeverisjes e të luftës politike brenda Kosovës nuk do të duhej të futeshin në këtë dokument me atë titull e me atë qëllim që është proklamuar. Futja e këtyre temave, nën maskën e analizës së raporteve të Kosovës me Serbinë, ose e ka qëllimin që ta trajtojë Kosovën si entitet brenda Serbisë, ose ta kompromontojë Kosovën si entitet, në pjesën e historisë së saj që kur ka filluar të dalë jashtë Serbisë. Të dy qëllimet janë skandaloze. Në paragrafin e tretë thuhet kështu: "Së këndeji, politikat destabilizuese të Serbisë ndaj Kosovës dhe rajonit të Ballkanit Perëndimor kanë njojur kohëve të fundit një përmasë të re: janë bërë më agresive, më të vrashda, duke shfrytëzuar me gjeturi dhe në mënyrë të vazhdueshme

situatat e paqarta dhe ndonjëherë kontradiktore në Bashkimin Evropian (BE), sikundër edhe ambientin e brendshëm politik të shteteve të rajonit dhe të klasave të tyre politike, të cilat kanë dështuar në reforma dhe janë shndërruar në oligarki sunduese."

Ky tekst në esencë shprehë tentativën për të relativizuar e arsyetuar politikën serbe të gjenocidit, të viteve nëntëdhjetë. Politikat e tashme të Serbisë janë vërtet destabilizuese, por janë larg nga politikat serbe të agresioneve ushtarake të viteve nëntëdhjetë, kur Serbia pati sulmuar ushtarakisht Sloveninë, Kroacinë, BEH dhe në fund Kosovën. Në letërsi teksti që nuk e shpreh realitetin, ose e shprehë në mënyrë të deformuar realitetin, quhet fikcion. Por ky tekst, nuk është i hartuar si fikcion. Është ose padituri e skajshme, ose qëllimi i errët, për të relativizuar e arsyetuar politikën serbe të gjenocidit në vitet nëntëdhjetë. Mundtë jetë pasojë e paditurisë, por në atë rast mund të shtrohet pyetja: si pranohen në Akademi njerëzit e padishëm?

Në pjesën "Miti serb për Kosovën" në dokumentin e ASHAK-ut thuhet ndër të tjera: "nuk ka pothuajse asnjë dallim midis bëmave të njërit nga heronjtë serb të Betejës së Kosovës, Marko Kraleviqit, dhe heroit të fikcionit letrar të Servantesit."

Duket e pabesueshme kjo shkallë e paditurisë së autorit/autorëve. E vërteta historike për Kraleviq Markun është se ai ka qenë person historik, dhe se ka marrë pjesë në Betejën e Kosovës në anën e osmanëve, kundër koalicionit serb. Arsyja është e njohur në histori: Kraleviq Marku pretendonte se ia kishin marrë të drejtën e sundimit, për ç'arsye ai

ftoi osmanët ta ndihmonin. Ai ishte vasal i osmanëve dhe sundonte në Prilep. Pjesëmarria e tij në luftë në krahun e osmanëve, Betejës së Kosovës i jep ngjyrimet e një konflikti civil ndërmjet serbëve, ndërsa osmanët ishin palë në ndihmë të vasalit të vet, pra, Kraleviq Markut. Këtë fakt histori kaq të thjeshtë autorि/autorët nuk e kanë ditur. Si pasojë e mungesës së dijeve historiografike, në mënyrë associative i janë referuar fikcionit, poeziës gojore serbe.

Fjalja pasuese është edhe më e hidhur: "Në kohën kur ka ndodhur, Beteja e Kosovës nuk ka qenë ndeshje civilizimesh, as ndeshje e dy botëve, e dy feve etj, por ka qenë një ndeshje e një ushtrie pushtuese, me një tjetër që mbrohej." Merreni me mend, dokumenti i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, i paraqet serbët si mbrojtës, ndërsa dihet se ata kishin pushtuar tokat arbëre (shqiptare) dhe e kishin thelluar procesin e asimilimit të tyre në serbë, për ç'gjë kanë sjellë fakte edhe historian të njohur si Peter Bartli dhe Noel Malkolmi. Fatkeqësish qasja sipas të cilës Beteja e Kosovës shikohet me dioptrinë e historiografisë serbe është shumë më e vjetër se sa ky dokument i Akademisë. Kjo qasje është e rrënjosur edhe në libra shkollorë. Në këtë aspekt historiografia serbe e ka pushtuar moti pjesën më të madhe të historiografisë, publicistikës dhe kulturës shqiptare. Ky dokument vetëm sa na e kujton këtë absurditet. Ndërsa e vërteta jetësore e historike është se osmanët kur kanë fituar në Betejën e Kosovës, e kanë filluar procesin e shkatërrimit të entiteteve shtetërore serbe, ndërsa

në ai proces kanë fituar arbërit-shqiptarët në mënyrë vendimtare. Mjafton të lexohet zakoniku i car Dushanit e të kuptohet se çfarë trajtimi mizor u bëhej të krishterëve latinë në Serbinë mesjetare.

Për herezinë latine:

Dhe të nxjerrë Kisha e Madhe protopopët në të gjitha qytetet dhe në të gjitha sheshet që të kthejnë krishterët nga herezia latine, ata që janë kthyer në fenë latine, dhe t'u jepet urdhër i shenjtë dhe të kthehet secili në krishterim.

Për popin latin:

Edhe popi latin, nëse gjendet, duke kthyer të krishterët në fenë latine, të dënohet sipas ligjit të etërve të shenjtë.

Për heretikun:

Dhe nëse ndokush gjendet si heretik, duke jetuar në mesin e të krishterëve, të damkoset nëpër fytyrë dhe të dëbohet, ndërsa kush do ta fshehte, edhe ai të ndëshkohet.

Pra, e vërteta është se sundimi serb i ka kthyer me shumicë dhe me dhunë katolikët në ortodoksi. Ndërsa kalimi i tyre më vonë në Islam ka qenë edhe si ikje nga asimilimi në serb që bëhej nëpërmjet administratës shtetërore dhe nëpërmjet Kishës Ortodokse Serbe.

Lidhur me kalimin e shqiptarëve në Islam, në dokument thuhet: "Konvertimi i kosovarëve nga të krishterë në myslimanë ka qenë një proces i gjatë i pushtimit, i detyrimit dhe i dhunës sistematike të Perandorisë Otomane(...). Autorët më seriozë që kanë studuar këtë proces, nuk thonë që ka ardhë si pasojë e "detyrimit dhe e dhunës sistematike." Njëri nga studiuesit më seriozë të kësaj problematike, prifti protestant që shërbeu si misionar në Shqipëri dhe Edvin Zhak, në studimin e tij

"Islamizimi i Shqipërisë në turqit" evidencon katër shkaqe përpranimin e Islamit nga shqiptarët: "mungesa e unititetit fetar në Shqipëri, karakteri dekadent i Krishterimit shqiptar, botëkuptimi materialist i shqiptarëve dhe, në fund, joshja e Islamit për natyrën shqiptare." (f.123)

Në një vend tjetër, Edvin Zhak jep edhe këtë konkluzion, i cili e rrënon hipotezën e konvertimit me presion: "Sidoqoftë, duke vërejtur përqindjen më të madhe të islamizimit në Shqipëri sesa gjetiu në Ballkan, dhe duke e pranuar se politika fetare osmane ishte mjft e ngjashme në rrëthanat e jashtme dhe të kohëzgjatjes dhe të intensitetit anembanë territorit të tij, jemi të detyruar të kërkojmë gjetkë për shpjegimin e islamizimit veçanërisht gjithëpërfshirës të Shqipërisë në krahasim me fqinjët e saj ballkanikë. Këto arsyë duhet të jenë subjektive dhe gjenden te karakteri dallues i Krishterimit shqiptar dhe i vetë shqiptarëve." (f. 146)

Si konkludim mund të them se kur një prift misionar, që ka shërbyer për konvertimin e shqiptarëve në krishterim, nxjerrë kësot përfundimesh, është krejt e palogjikshme që ASHAK të na servojë qasjen se gioja konvertimi është bërë me detyrim dhe dhunë sistematike. Qasja e tillë është e rrënjosur në historiografinë serbe. Prej anej është huazuar edhe në këtë dokument e edhe në shumë kontributë të tjera pseudoshkencore.

Në një pjesë të dokumentit thuhet edhe sa vijon: "Ballkani Perëndimor gjithnjë e më shumë po largohet nga politikat e BE-së dhe NATO-s dhe po bëhet pjesë e boshteve asimetrike që lidhen me

Euro-Azinë." E kundërtë është e vërtetë. BeH sivjet mori statusin e shtetit kandidat. Samiti i Tiranës ishte inkurajes për dinamizimin e procesit të integrimit të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Evropian. I vetmi shtet që qëndron larg politikave të BE-së dhe të NATO-s është Serbia. Por, ky fakt maskohet në tekstin.

Edhe ky pasus i dokumentit meriton vëmendje, për ta dekonstruktuar pozicionin politik e moral të autorëve të këtij dokumenti: "Nuk ka shumë rëndësi nëse do të ndodhë "çështja e tabelave" ose jo, nëse do të ndodhë ky "veprim provokues" i Kosovës, sepse Serbia do ta krijonte pa më të voglën mëdyshje një situatë të këtillë tensionimi..." Pra, me anën e një spekulimi thjesht fshihet përgjegjësia për mospranimin e këshillës së SHBA për të shtyrë problemin e targave për dhjetë muaj. Eskalimi është pasojë e atij vendimi. Pasioni për ta arsyetuar çdo veprim të qeverisë aktuale e për të shfryrë ndaj qeverive të kaluara, mbetet një njollë morale për autorët dhe përvetë Akademinë. Fatkeqësish, ky është si një rikthim simbolik në kohën kur kjo Akademi u formua nga regjimi komunist jugosllav, për t'i shërbyes kauzës së atij regjimi. E sigurt më duket se emrat që atëherë u dekretna si akademik të porsazgjedhur nga Ilja Vakiqi, kanë qenë më dinjitozë se sa këta të sotmit. Ky është absurditeti i kësaj Akademie, e cila nuk po do të shkëputet nga statusi si një shërbëtore vullnetare e pushtetive. Ndoshta edhe më keq, ASHAK me këtë dokument u prezantua edhe si tellall i trashëgimisë politike e kulturore të kohës së errëta të okupimit sllav.



Këtë vit pritet stabilizimi i çmimeve dhe ulja e inflacionit



PRISHTINË, 26 SHKURT - Drejtori ekzekutiv i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë, Arian Zeka, ka kërkuar nga qeveria një mekanizëm të centralizuar për dialogim publiko-privat përmes të cilit odat ekonomike do të mund t'i adresonin shqetësimet e ndërmarrjeve të sektorit privat pasi që, sipas tij, qeveritë nuk janë duke i kushtuar rëndësi kësaj çështjeje.

Zeka ka theksuar se misionet diplomatike të Kosovës, kudo që ekzistojnë, duhet të

avancohen në promovimin e potencialeve për investime dhe eksportet të Kosovës.

Në një intervistë për "Kosovapress", Zeka flet edhe për irritjen e çmimeve, për çka thotë se deri në tremujorin e fundit të këtij viti do të ketë stabilizim të çmimeve. "Sa i përket inflacionit dhe kostos së jetesës në përgjithësi duket se nuk ka pasur ende një përmirësim përgjatë këtij viti. Ndryshim të vetëm ka pasur të çmimi i karburanteve, si çmimi i produkteve të energjisë në

përgjithësi. Ajo që presim eshtë se deri nga pjesa e tremujorit të fundit të këtij viti të fillojë të ketë një stabilizim të çmimeve të produkteve anembanë botës. Ky eshtë edhe një parashikim i institucioneve financiare ndërkombëtare që deri në fillim të vitit 2024 do të kemi stabilizim të inflacionit ose ulje të inflacionit, i cili ka shënuar rritje të jashtëzakonshme në këto tre vjet, nga shpërthimi i pandemisë Covid-19, por edhe njës së luftës në Ukrainë", ka deklaruar Zeka.

Mbi 22 mijë familje në Kosovë përfituese të skemës sociale

PRISHTINË, 26 SHKURT - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar Statistikat e Mirëqenies Sociale përmuanjan janar 2023. Sipas rezultateve të dala nga ky publikim, rezulton se gjatë muajit janar 2023 nga skema e ndihmës sociale kanë përfituar 22 571 familje me gjithsej 89 318 anëtarë, ndërsa nga skema përmuanjan janë 2 894 familje. Nga skema e pensioneve bazë të moshës janë 140 71 përfitues; nga skema e pensioneve kontributpaguese të moshës janë 46 467 përfitues; nga skema përveteranët e luftës janë 36 767 përfitues, ndërsa nga skema e pensioneve përversonat me aftësi të kufizuara janë 17 718 përfitues. Po ashtu, ASK-ja ka

bërë të ditur se nga skema përfituese e dëshmori të invalidët e luftës janë 13 052 përfitues; nga skema përpensionet familjare janë 3 261 përfitues; nga skema përpensionet e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë janë 2 470 përfitues; nga skema e kompensimeve përversonat e verbër janë 1 639 përfitues; nga skema përpensionet e Trepçës janë 1 707 përfitues; nga skema e pensioneve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK) janë 1 284 përfitues; nga skema e pensioneve përvor Forcën e Sigurisë së Kosovës janë 704 përfitues; dhe nga skema përversonat invalidore janë 60 përfitues. Ndërsa gjatë muajit janar 2023 nuk është raportuar asnjë rast i fëmijëve të braktisur.



Vlera e valutës iraniiane bie në nivele rekorde



TEHRAN, 26 SHKURT - Vlera e valutës së Iranit ka rënë në nivele rekorde kundrejt dollarit amerikan ditën e diel, derisa protestat kundër qeverisë kanë hyrë në muajin e pestë. Një bllokadë në ringjallje të marrëveshjes bërtimore të cilën Teherani e ka nënshkruar me fuqitë botërore më 2015 e ka dëmtuar, po ashtu, valutën iraniiane.

Tregtarët në Teheran i kanë këmbyer 600 000 rialë përvjetorë

dollar amerikan të dielën, pasi valuta është dobësuar përtëj 500 000 rialëve, sa është kryer këmbimi përvjetorë.

Në këtë periudhë të vitit 2015, 32 000 rialë janë këmbyer përvjetorë, pasi Iranit iu patën hequr sanksionet ndërkombëtare në këmbim të kufizimit të aktivitetit bërtor.

Qendra e Statistikave e Iranit ka thënë javën e kaluar se shkalla e

inflacionit ka arritur në 53.4 përvjetorë.

Në janar të vitit 2021 kjo shifër ka shkuar në 41.4 përvjetorë.

Irani është përballur me protesta mbarëkombëtare prej muajit shtator të vitit të kaluar. Protestat kanë shpërthyer pas vdekjes së 22-vjeçares Mahsa Amini, sa ka qenë në mbajtje nga policia e moralit, nën supozimet se nuk e ka vendosur si duhet mbulesën në kokë.

Në 'superpuna' janë edhe 1413 pozita të lira pune

PRISHTINË, 26 SHKURT - Ministri i Financave, Hekuran Murati, ka bërë me dije se aktualisht në "superpuna" janë 1 413 pozita të lira pune përvjetorë. Ai bëri me dije se paga mesatare e

këtyre pozitave është 358 euro por, sipas tij, ka paga që shkojnë edhe deri në 1 000 euro. "Aktualisht në superpuna janë 1 413 pozita të lira pune përvjetorë, rrinjtë 18-25 vjeç. Paga mesatare e këtyre pozitave

është 358 euro, që nënkuption se shumica e bizneseve po shtojnë pagën mbi subvencionin e Qeverisë, por ka paga që shkojnë edhe deri në 1,000 euro", ka shkruar Murati në "Facebook".



Kush janë qytetet më të vjetra të banuara në botë



Rreth vittit 10.000 Para Krishtit njerëzimi fillimisht filloj të vendosej në komunitet të vogla bujqësore, të cilat u zgjeruan më pas për të krijuar qytetet e para në botë. Shumë qytete të famshme nga këto djepë tē hershme tē qytetërimit – në Lindjen e Mesme, Kinë dhe Indi – janë zhdukur nga faqja e dheut. Por disa vazhdojnë tē jenë tē banuara ende sot. Ja cilët janë ato.

Luojang, Kinë

I ndodhur në provincën Henan, ai është një kandidat i fortë për qytetin më të vjetër në Lindjen e Largët. Besohet se u themelua gjatë dinastisë e parë misterioze të Kinës, Xia, e cila sundoi një pjesë të Kinës përpara zhvillimit të fjalës së shkruar. Në vitin 1959 arkeologët gërmuan mijëra objekte të punuara me mjeshtëri në Luojang, të cilat datojnë që nga viti 1600 Para Krishtit, pra rrëth kohës kur supozohet se sundoi dinastia Xia. Midis tyre kishte objekte të çmuara prej bronzi dhe bizhuteri luksoze prej nefriti, që sugjerojnë një qytetërim antik shumë të organizuar.

Varanasi, India

Eshtë ndoshta qyteti më i vjetër ende i banuar në Indi, dhe padyshim një nga më të shenjtët. I vendosur buzë lumit Gang, ky qytet tërheq ende sot vizitorë nga e gjithë India, të cilët mblidhen në brigjet e lumit për të varrosur të afërmit e tyre. Historia e qytetit eshtë e lidhur ngushtë me disa histori fetare. Disa zbulime arkeologjike në

vitin 2014, konfirmuan se njerëzit kanë jetuar në këtë zonë të paktën që nga viti 1800 Para Krishtit. Budistët besojnë se Buda predikoi afër qytetit. Ndërsa Hindusët besojnë se qyteti u themelua nga Perëndia Shiva. Besohet se ata që vdesin në Varanasi janë të bekuar, pasi janë në gjendje të dalin nga cikli i pafund i vdekjes dhe rilindies

Tiri, Liban

Ky qytet ishte dikur një nga më të pasurit në botë, ndërsa sot është një nga më të vjetrit. Të paktën 4.000 vjet i vjetër, Tiri ishte tashmë një qytet i madh që në vitin 2000 para Krishtit si një port tregtar shumë fitimprurës për fenikasit. Qyteti përmendet shumë shpesh në Bibël, në Dhiatën e Vietër dhe Dhiatën e Re.

Edhe pse fenikasit ndërtuan shumë qytete të mëdha në të gjithë bregun e Mesdheut, Tiri ishte një nga më të rëndësishmit për shkak të industrisë së tij të famshme të bojës. Boja e purpurtose vjollcë është shumë e vështirë pér t'u prodhuar, sepse është një nga ngjyrat më të rralla në natyrë. Por banorët e Tirizbuluan se mund të lyenin pëlburat me këtë ngjyrë, duke

Argos, Gregi

Është një nga qytetet më të vjetra të Greqisë. Kodra e Elias

mbi qytet u banua për herë të parë nga njerëzit e Epokës së Gurit që në vitin 3500 Para Krishtit. Argos u bë një qytet i madh gjatë Periudhës Mikenase të Epokës së Bronzit. Shumë kohë përpëra se Greqia të zbukurohej me tempuj klasikë dhe teatro të lashtë, grekët mikenas jetonin në një mënyrë më primitive, të organizuar politikisht rrëth një sërë kompleksesh të vogla pallatesh në vende si Argosi

Jerusalem, Israel

Ka qenë i banuar që nga viti 3500 Para Krishtit. Gjatë historisë së tij të hershme, Jeruzalemu pushtua nga mbreti David, ndoshta rreth vitit 1000 Para Krishtit. Historia e këtij qyteti ka qenë gjithmonë shumë e trazuar. Tempujt e parë të hebrenjve u shkatërruan nga babilonasit dhe romakët. Me ngritjen e Krishterimit dhe Islamit, Jeruzalemi u bë gjithashtu një qytet i shenjtë për shumë njerëz të tjerë, gjë që do të thotë se ai ka ndryshuar shumë herë duar midis feve të ndryshme, ndonjëherë me dhunë, si gjatë Kryqëzatave. Debatit se kush e zotëron vërtet qytetin e shenjtë vazhdon edhe sot.

Plovdiv, Bulgaria

Vlerësohet të jetë qyteti më i vjetër në Evropë që është banuar vazhdimi. I ndërtuar mbi shtatë kodra ashtu si qyteti i Romës, Plovdiv është pushtuar në kohë të ndryshme nga maqedonasit, romakët, bizantinët dhe osmanët. Sot, muzeu i jashtëzakonshëm i

Plovdivit pérmban një koleksion mbreslénës prej të paktën 100.000 artefaktesh nga disa mijëra vite të historisë së tij. Fillimisht qyjeti lulëzoi si pjesë e Trakisë së lashtë, ndërsa më pas u pushtua nga Filipi II i Maqedonisë (babai i Aleksandrit të Madh).

Raj-Iran

Eshtë ndër qytetet më të vjetra në Iran. Gjetjet arkeologjike tregojnë se banorët e tij prodhuan qeramikë që në vitin 5500 Para Krishtit. Ndërsa kaj qenë dëshmitar i shumëngjarjeve të mëdha, përfshiret pushtimet e hordhive mongole dhe ngritjen e Islamit, qyteti eshtë i famshëm për lidhjen me profetin Zoroaster. Raji përmendet në librin e shenjtë Zoroastrian Avesta.

Faijum, Egipt

Është një qytet oaz buzë lumi Nil, i pushtuar për herë të parë rreth vitit 7200 Pra Krishtit, dhe një komunitet i rëndësishëm bujqësor të paktën që nga viti 5200 Para Krishtit. Në kohët e lashta, Faijum përbëhej nga disa qytete që janë shkrirë së bashku, ku më i famshmi dhe më i fuqishmi prej ishte Shendet. Për një kohë të shkurtër ai ka qenë edhe kryeqyteti administrativ i Egjiptit gjatë Dinastisë XII-të, duke u bë një simbol i fuqisë mbretërore.

Erbil, Irak

Vendndodhja e njërsës prej kështjellave më të vjetra dhe më spektakolare në Lindjen e Mesme, Erbili, ashtu si shumë

qytete të Lindjes së Mesme, lidhej me një hyjni specifike. Ishtar, Mbretëresha e Parajsës, mbrojtëse e qytetit. Tempulli i shenjtë i Ishtarit, së bashku me pjesën tjetër të qytetit antik, është varrosur nën tokë. Kështjella e Erbilit mund të datojë që në vitin 7000 Para Krishtit, duke e bërë atë ndër qytetet më të viетra në botë.

Damask dhe Alepo në Siri

Është banuar nga njerëzit e lashtë midis viteve 8000–10.000 Para Krishtit. Në fillim ishte një zonë pjellore tërheqëse për fermerët, ndërsa më vonë u bë ishte i njobur për mëndafshin damask dhe jaseminin aromatik. Ishte vendi i përsosur ku pelegrinët dhe karvanët etregtarëve mund të pushonin dhe

shpenzonin paratë e tyre. Epoka e artë e Damaskut erdhë gjatë Mesjetës kur u bë kryeqyteti i kalifatit mysliman Umajad. Ndërkokë gërmimet arkeologjike kanë zbuluar se njerëzit janë varrosur përreth Alepos që rrëth vitit 11.000 Para Krishtit, gjë që e bën atë një kandidat të fortë për qytetin më të vjetër në botë. Ashtu si me Damaskun, shumë njerëz kalonin transit në Alepo kur udhëtonin përgjatë Rrugës së Mëndafshit, që sillte mallra ekzotike nga Kina në Evropë. Qyti u bë shumë i famshëm kur mori statusin e kryeqytytetit mesjetar të dinastisë Hamdanide, teksha u pushtua nga Aleksandri i Madh, romakët, arabët, mongolët dhe osmanët.

*Marrë me shkurtime nga
Grunge – Bota.al*



Prishtina shijon fitoren e parë në pranverë, Dukagjini ndali Ballkanin

"Epoka e re"

PRISHTINË, 26 SHKURT - Të janë zhvilluar tri ndeshjet e fundit të javës së 22-të në Albi Mall Superligën e Kosovës në futboll. Prishtina mposhti Llapin, me rezultat 2-0 në stadiumin "Zahir Pajaziti" në Podujevë, duke i dhënë fund serisë së rezultateve negative në fillim të këtij stinori. Në fakt, kjo ishte fitorja e parë e Prishtinës në pranverë pas tre humbjeve radhazi, ndërsa Llapit pësoi humbjen e parë pas tri fitoreve rresht. Golat u shënuan në minutën e 41-të nga Albin Prapashtica dhe në minutën e dytë të kohës shtesë nga Endrit Krasniqi, i cili përfitoi nga gabimi i portierit Ilir Avdyl. Plikë si mysafir shkëputi edhe Dukagjini i Klinës, që arriti ta ndalë në barazim kampionin në fuqi,

Ballkanin, me rezultat 1-1, në fushën me bari sintetik në Suharekë. Klinasit kaluan të parët në epërsi me golin e Otto John nga penaltia në minutën e 18-të, ndërsa Albion Rahmani shënoi sërisht gol për Ballkanin në minutën e 56-të, duke e vendosur rezultatin përfundimtar. Pavarësisht barazimit, Ballkan mbetet lider në tabelë me 48 pikë, ndërsa Dukagjini ndodhet në vendin e gjashtë me 26 pikë. Në ndeshjen tjetër, Gjilani fitoi ndaj Trepçës '89 në shtëpi, me rezultat 1-0. Golin e vetëm të ndeshjes e shënoi Albert Dabiqaj në minutën e 76-të. Kjo ishte fitorja e dytë e radhës për Gjilanin, ndërsa Trepça '89 pësoi humbjen e tretë të njëpasnjëshme në pranverë. Ferizaj ka triumfuar me përmbysjë të rezultatit, 2-1, në



sfidën kundër Dritës. Kastriot Selmani shënoi gol të bukur për mysafrët në minutën e 53-të, por Ferizaj arriti të barazoi shifrat me një gol të Ergon Hysenit pesë minuta më vonë. Ndërkohë, Betim Haxhimusa u bë hero i Ferizajt, duke shënuar golin e fitores në minutën e 85-të, duke dhuruar emocione të mëdha tek

tifozët vendas. Në ndeshjen tjetër, Malisheva fitoi ndaj Drenicës me rezultat 3-1. Sulmuesi Ronald Sobowale i dha epërsinë vendasë në minutën e 12-të, por Drenica barazoi menjëherë më pas me një gol spektakolar të Abazit. Megjithatë vidasit vazhduan me lojë të mirë, ku Drilon Hazrollaj shënoi

SUPERLIGA	
Balkani - Dukagjini	1-1
Gjilani - Trepça '89	1-0
Llapi - Prishtina	0-2
Malisheva - Drenica	3-1
Ferizaj - Drita	2-1
Tabela	
1. Ballkan	48 pikë
2. Drita	44
3. Gjilani	35
4. Prishtina	30
5. Llapi	29
6. Dukagjini	26
7. Malisheva	24
8. Trepça '89	22
9. Ferizaj	21
10. Drenica	20

nga gjuajtja e lirë, ndërsa Adem Maliki vendosi rezultatin përfundimtar 3-1, në minutën e 59-të. Kjo ishte fitorja e parë e Malishevës.

Trepça vazhdon me fitore



PRIZREN, 26 SHKURT - KB Trepça pas fitimit të Kupës, ka vazhduar serinë e fitoreve në Prince Caffe Superligë. Mitrovicasit kanë mundur Bashkimin me shifrat 84:87 (18:23, 23:26, 22:19, 21:19), në kuadër të javës së 23-të. Çerekut i parë ishte interesant, ku pas një fillimi të barabartë, mysafrët me një seri prej 0:7, kaluan në epërsi 17:21, derisa këtë pjesë e fituan 18:23. Mitrovicasit vazhduan me lojë të mirë dëgjatë, që shkoi deri në 12 pikë, 22:34, dhe gjatë gjithë pjesës së parë ishin në epërsi, duke shkuar në pushim me rezultat 41:48. Prizrenasit ishin më të mirë në periodën e tretë, ku barazuan shifrat në 56:56, derisa më pas zhvillohet lojë kryesisht e barabartë, ndërsa rezultati pas 30 minutash ishte 63:68. Kjo bëri që fituesi të vendosej në çastet e fundit, ashtu edhe së ndodhi, por më të vëmendshëm ishin mitrovicasit

që vazhduan me fitore dëgjatë, 84:87. Te Bashkimi u dalluan Samardo Samuels me 19 pikë e nëntë kërcime, Fisnik Rugova me 16 pikë e tetë kërcime dëgjatë, Daniel Lekndreaj me 12 pikë e dhjetë kërcime, kurse te Trepça u dalluan Kendrick Brown me 23 pikë e gjashtë kërcime dëgjatë, Drilon Haxhimusa u bë hero i Ferizajt, duke shënuar golin e fitores në minutën e 85-të, duke dhuruar emocione të mëdha tek

Pa fitues në derbin Prishtina-Rahoveci



PRISHTINË, 26 SHKURT - Nuk ka dhënë fitues derbi i xhiros së parë në Superligën A të Kosovës në hendboll. Në kuadër të javës së 19-të kampionale, Prishtina e Rahoveci luajtën 26:26, të dielën mbrëma në kryeqytet. Prishtina nuk ia doli t'i revanshohet Rahovecit për humbjen e shkaktuar në ndeshjen e kaluar. Ndesha ishte e fortë dhe e hapur deri në fund. Në pjesën e parë, Prishtina krijoj epërsi deri

në dy gola u shkëputën të dy skuadrat, kurse Alban Haziri shënoi golin e fundit për 26:26. Arti Luzha i Rahovecit bëri pritje në fund. Agon Bajqinovci i Prishtinës i shënoi dhjetë gola, ndërsa shtatë i kishte Oltion Beshiri. Endrit Tafarshiku shënoi tri gola. Alban Haziri ishte më efikasi te Rahoveci me 12 gola. Nga tri i shënuan Marley Wallace Fernandes dhe Besmir Kusari. Ndërkohë Besa

Famgas ka vazhduar me fitore. E ka mposhtur në Pejë skuadrën e Vushtrrisë me rezultat 33:28. Arbës Mushkolaj dëgjatë, Franco Daniel Gavida shënuan nga shtatë gola për Besën. Gjashtë i kishte Jon Muqolli. Te Vushtrria, Nemanja Drakuloviqi shënoi 11 gola, ndërsa shtatë i kishte Bozhidar Nikoçeviq. Fitoren më bindëse në Superligën A e shënoi Trepça. Në "Minatori", mitrovicasit fituan ndaj

Kastriotit të Ferizajt me rezultat 37:22. Trepça u shkëput herët për të vazhduar ecurinë pozitive. Deniz Terziqi i shënoi nëntë gola për Trepçën, ndërsa shtatë i kishte Shpëtim Mehmeti. Me dy gola kontribuoi edhe portieri Meriton Lladrovci që pati tjetër ndeshje të dalluar. Te Kastrioti, nëntë gola i shënoi Festim Mustafa, ndërsa pesë i kishte Jeton Bislimi.

S'ka këndellje për Chelsean as ndaj Tottenhamit

LONDËR, 26 SHKURT - Tottenham Hotspur ka arritur një fitore të rëndësishme ndaj Chelseat, 2-0 në atë që cilësohet si derbi i Londrës. Pjesa e parë

foli më shumë për ekipin e Potter, por pa mundur të gjenin rrugë drejt rrjetës duke bërë që të mbyllej pa gola. Gjithçka ndryshoi në sekondat e para të pjesës së

dytë, teksha Oliver Skipp do të zhbllokonte ndeshjen me një super gol, i cili është i pari për të në Premier Ligë. Në minutën e 82-të, Tottenham do të dyfishonte shifrat. Pas

në goditje nga këndi të ekzekutuar nga Heung-Min Son, Dier asiton Harry Kane, i cili tregoi insektin e sulmuesit për të vulosur derbin.





The banner features the RC Cola logo at the top left, followed by a large yellow box containing the text "ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS". Below this, a section titled "Quality & Sales Award Recipients" lists ten companies in alphabetical order, each marked with a star. To the right of the banner are two RC Cola products: a blue can and a dark plastic bottle, both with the brand's signature red swoosh.

Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladaora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Qualtiy
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



The advertisement features a circular tin of MEKA Halal Food Pashtetë Pule. The tin is orange with a white lid. The lid features a photograph of a sandwich filled with meat and cheese, garnished with herbs. Text on the lid includes "MEKA HALAL FOOD", "PASHTETË PULE", "cili e garantuar", "pa konservues", "gluten free", and "100 % mish pule". The background of the ad is a stylized orange and white graphic.